**VENDIM**
**Nr.35, datë 25.7.2011**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Bashkim Dedja | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese | | |
| Vladimir Kristo | Anëtar i“ | “ | |
| Xhezair Zaganjori | Anëtar i“ | “ | |
| Vitore Tusha | Anëtare e | “ | “ |
| Sokol Sadushi | Anëtar i“ | “ | |
| Sokol Berberi | Anëtar i“ | “ | |
| Altina Xhoxhaj | Anëtare e | “ | “ |
| Petrit Plloçi | Anëtar i | “ | “ |

me sekretare Blerina Çinari, në datë 8.3.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.3 Akti që i përket:

KËRKUES: Arturo Verzeroli, i përfaqësuar nga avokat Delo Isufi, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Mirbana Bilali, e përfaqësuar nga avokat Artan Kodheli, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr.883, datë 30.6.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr.616, datë 21.5.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi; përfaqësuesin e kërkuesit që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesi, shtetas italian, është paditur nga subjekti i interesuar, ish-bashkëshortja e tij shtetase shqiptare, e cila ka kërkuar në gjykatë zgjidhjen e martesës, lënien e fëmijës për rritje dhe edukim dhe pagimin e detyrimit ushqimor në favor të fëmijës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.7141, datë 28.7.2008, ka vendosur pranimin e padisë, zgjidhjen e martesës, lënien e fëmijës për rritje dhe edukim subjektit të interesuar, duke i njohur kërkuesit të drejtën e takimit me fëmijën javën e parë dhe të tretë të çdo muaj prej orës 14.00 të ditës së shtunë deri në orën 14.00 të ditës së diel, si dhe ta marrë fëmijën 20 ditë për pushime verore, në periudhën korrik-gusht të çdo viti, detyrimin e kërkuesit që të paguajë në favor të fëmijës një kontribut ushqimor në masën 50 000 lekë në muaj, duke filluar ky detyrim nga dita e ngritjes së padisë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 883, datë 30.6.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.7141, datë 28.07.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, me vendimin nr.616 datë 21.5.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit kundër vendimit nr.883, datë 30.6.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Kërkuesi ka pretenduar para Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) se vendimet e kundërshtuara

janë marrë në cenim të së drejtës së tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, për arsye:

- të cenimit të së drejtës për të pasur ndihmën e një përkthyesi (nenet 31/c e 42 të Kushtetutës;
- të cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur (nenet 31, 33, e 42 të Kushtetutës);
- të mungesës se arsyetimit të vendimit gjyqësor (nenet 42 e 142 të Kushtetutës);
- të cenimit të parimit të ligjshmërisë.

II

**1. Për pretendimin për cenimin e të drejtës për të pasur ndihmën e një përkthyesi (neni 31/c i Kushtetutës)**

Kërkuesi pretendon se atij nuk i është dhënë mundësia të ketë ndihmën e një përkthyesi gjatë zhvillimit të gjykimeve.

Në kontekstin e këtij pretendimi, Gjykata thekson se e drejta e individit palë e një gjykimi, për të pasur ndihmën e një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe (neni 31/c i Kushtetutës), është një parakusht i respektimit të së drejtës për t'u dëgjuar para se të gjykohet (neni 33 i Kushtetutës), i cili është një nga garancitë themelore për realizmin e të drejtës për një proces të rregull ligjor të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata vlerëson gjithashtu se e drejta për të pasur ndihmën e një përkthyesi, kur nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën shqipe, edhe pse në mënyrë të shprehur është sanksionuar si një e drejtë e të akuzuarit në një proces penal (neni 31/a i Kushtetutës dhe neni 6/3/a i KEDNJ-së), kjo e drejtë përfshin edhe procesin e gjykimit të të drejtave civile. Gjykata, referuar edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, vëren se e drejta e individit palë e një gjykimi, për t'u informuar në gjuhën që kupton, është vlerësuar në funksion të së drejtës së mbrojtjes.

Bazuar në konsideratat e mësipërme, si dhe në parimin e përgjithshëm të vetëpërgjegjësisë së palës në një gjykim civil, Gjykata vlerëson se, në kuadrin e këtij procesi, e drejta e individit "*për të pasur ndihmën pa pagesë të një përkthyesi nëse nuk kupton ose nuk flet gjuhën shqipe",* ndryshe nga kjo e drejtë në procesin penal, është subjekt i kushtit të dhënies së ndihmës juridike falas, të cilën individi jo vetëm është i detyruar ta kërkojë, por edhe të provojë pamundësinë e tij financiare për të përballuar shpenzimet e gjykimit. Vetëm në këto kushte gjykatat e juridiksionit të zakonshëm janë të detyruara që në përmbushje të detyrimit kushtetues, për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor, t'i caktojnë individit, palë të një gjykimi civil, një përkthyes që zyrtarisht të këtë njohuri mbi gjuhën e tij, duke qenë formalisht kompetent në njohjen e gjuhës së tij. Në të kundërtën, Gjykata, bazuar në parimin e përgjithshëm të gjykimit civil të vetëpërgjegjësisë së palës, çmon se individi ka të drejtën dhe detyrimin që ta organizojë vetë mbrojtjen e tij, duke caktuar *një përkthyes dhe/ose edhe një mbrojtës*, duke përballuar paraprakisht/parapaguar shpenzimet e tij.

Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuesit për cenim të së drejtës *për të pasur ndihmën pa pagesë të një përkthyesi*, është i pabazuar. Kështu, nga një sërë dokumentesh të dosjes gjyqësore, si procesverbali i seancës gjyqësore të datës 7.7.2008, prokura e përgjithshme e lëshuar nga kërkuesi për avokatët e tij, ku njëri prej tyre ka shërbyer edhe si përkthyes, procesverbali i seancës gjyqësore i datës 21.07.2008, akti i vlerësimit psikologjik, Gjykata arrin në konkluzionin se edhe kërkuesi personalisht ka qenë mjaftueshmërisht i informuar për natyrën dhe shkaqet e mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Gjykata, gjithashtu, vlerëson se, duke pasur parasysh se kërkuesi ka qenë i përfaqësuar nga avokatët e tij, kërkuesit nuk i është cenuar as e drejta për të përgatitur mbrojtjen, sepse kërkuesi e ka organizuar mbrojtjen e tij, duke caktuar vetë avokatët e tij, njëri prej të cilëve di dhe gjuhën e kërkuesit.

Për sa më sipër, Gjykata konkludon se nuk vërehet cenim i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenet 31/c e 42 të Kushtetutës.

**2. Për pretendimin për cenimin e të drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur**

Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se i është cenuar e drejta kushtetuese për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në gjyq. Gjykata vëren se cenimin e kësaj të drejte kërkuesi e mbështet në pretendimin se gjykimi në shkallë të parë, në mungesë të avokatëve të tij, është bërë në shkelje të nenit 175 të Kodit të Procedurës Civile, pasi sipas tij, mosparaqitja e avokatëve ka ndodhur për një shkak të ligjshëm.

Gjykata për këtë pretendim vë në dukje se sipas nenit 175 të Kodit të Procedurës Civile "*gjykata verifikon paraqitjen e palëve dhe heton shkaqet kur njëra ose të dyja ato nuk janë paraqitur në seancë" dhe se, ..."në rast se mosparaqitja ka ndodhur për shkak sëmundjeje ose për ndonjë shkak tjetër të ligjshëm, gjykata shtyn gjykimin për një ditë tjetër"*. Kjo dispozitë ka si qëllim garantimin e së drejtës kushtetuese të individit për t'u dëgjuar para se të gjykohet, e drejtë kjo që përfshin në vetvete edhe të drejtën për t'u mbrojtur. Si rrjedhim, shkelja e kësaj procedure për verifikimin e paraqitjes së palëve, dhe gjykimi i çështjes në mungesë, mund të sjellë si pasojë edhe cenimin e të drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

Në rastin në shqyrtim, bazuar në aktet e dosjes, Gjykata vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur dijeni për kërkesën e parashtruar nga mbrojtja e kërkuesit për të shtyrë gjykimin. Si rrjedhim i këtij vlerësimi, Gjykata arrin në konkluzionin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë gjatë gjykimit të zhvilluar prej saj nuk i është shmangur detyrimit, për të garantuar të drejtën kushtetuese të kërkuesit për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur. Gjykata vlerëson se edhe Gjykata e Apelit Tiranë nuk i është shmangur këtij detyrimi. Nga aktet e dosjes nuk rezulton që kërkuesi, mbrojtja e tij, të kenë parashtruar para Gjykatës së Apelit Tiranë, në përputhje me karakterin e gjykimit rishikues që kryet prej saj, ndonjë kërkesë për ta gjykuar çështjen në fakt, nëpërmjet përsëritjes tërësisht ose pjesërisht të hetimit gjyqësor.

Në rrethanat e mësipërme, Gjykata konkludon se nuk vërehet cenim i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

**3. Për pretendimin e mungesës së arsyetimit të vendimit gjyqësor**

Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se vendimet gjyqësore janë të paarsyetuara, në shkelje të neneve 42 e 142/1 të Kushtetutës.

Në këtë drejtim, Gjykata rikonfirmon qëndrimin e saj se arsyetimi i vendimeve gjyqësore është një element i së drejtës për një proces të rregull ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së. Mes të tjerash, nëpërmjet arsyetimit të vendimit, gjykata u demonstron palëve se ata janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta apelojnë këtë vendim, si dhe organeve të apelit ta shqyrtojnë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet: nr.8, datë 16.3.2011; nr.38, datë 30.12.2010; nr.7, datë 09.3.2009 nr.25. datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

Megjithatë, edhe pse neni 42 i Kushtetutës i detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre, kjo nuk mund të kuptohet sikur kërkohet një përgjigje e detajuar për çdo argument (*shih vendimin nr.23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata thekson, gjithashtu, se vendimi gjyqësor, në tërësinë e tij duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit. Përveç kësaj, argumentet e vendimit duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese, (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 9.3.2009; nr.23, date 23.7.2009; nr.38, datë 30.12.2010; nr.8, datë 16.3.2011*).

Në rastin në shqyrtim, Gjykata, për sa më sipër, për pretendimin e kërkuesit për mungesën e arsyetimit të vendimit, vlerëson se gjykatat e juridiksionit gjyqësor të përgjithshëm në vendimin e tyre kanë arritur të shpjegojnë mjaftueshëm arsyet e themelit të dhënies së vendimit, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të subjekteve në gjykim, çka ka përmbushur përgjithësisht detyrimin për

arsyetimin e vendimit gjyqësor, sanksionuar në nenin 142 të Kushtetutës.

Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se, gjatë gjykimit të çështjes, kërkuesit nuk i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

**4. Për pretendimin e cenimit të parimit të ligjshmërisë**

Kërkuesi ka pretenduar edhe për cenimin e parimit të ligjshmërisë për shkak të mosrespektimit të Konventës europiane mbi të drejtat e fëmijës.

Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për mosrespektimin dhe zbatimin e keq të Konventës europiane "Mbi të drejtat e fëmijës" ka të bëjë me aspektin e zbatimit të ligjit material nga ana e gjykatave të zakonshme të pushtetit gjyqësor. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton jurisprudencën e konsoliduar të saj se për pretendimet që kanë të bëjë me zbatimin e ligjit material kanë atribut të investohen vetëm gjykatat e zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete, për sa kohë që nuk vëren raste të shkeljes së standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Në këtë kushte, Gjykata arrin në përfundimin se në tërësinë e tij procesi i zhvilluar në të tri shkallët e gjykimit, në aspektin kushtetues, ka qenë i rregullt. Për pasojë, kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Arturo Verzeroli duhet të rrëzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Altina Xhoxhaj